



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

TERMA REFERENCE

*Supervizion punimesh në objektin:
“Zgjerimi i rrugës Elbasan – Qafë Thanë”, (FAZA III).*

TIRANË 2023

I. TË PËRGJITHSHME

Me fondet e buxhetit të shtetit per vitin 2022 dhe në vazhdim, janë parashikuar punime në objektin: “Zgjerimi i rrugës Elbasan – Qafë Thanë, (FAZA III)”. Për këtë i kërkohet mbikqyrësit të punimeve të kësaj kontrate, të kryejë mbikqyrjen e punimeve të objektit, pas vlerësimit të projektit për fondin limit të llogaritur sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

II. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekt-zbatimi fillon ne fshatin Labinot Fushe ne km -0+120, prane ures metalike mbi lumin Shkumbin dhe perfundon ne km 11+140, pas ures se Murrashit, me gjatesi 11260ml.

Ne piken e fillimit me rruga do te lidhet me projektin e Bypass-it te Elbasanit, ndersa ne piken e mbarimit do te vazhdoje nje faze e mevonshme e ketij projekt-zbatimi.

Rruga nacionale ekzistuese Elbasan – Qafe Thane ka gjerësi totale 9.75 - 10.25m (8.25 m gjerësi asfalti dhe bankina me gjerësi 0.75-1m).

Ky segment rrugor kalon pergjithesisht ne nje aks te ri. Devijimi nga aksi ekzistues behet kryesisht per te plotesuar parametrat teknike te kategorise B, ndersa ne pjesen fundore te segmentit eshte ruajtur e paprekur rruga ekzistuese dhe ura ekzistuese e Murrashit, me qellim qe te sherbeje si ruge lidhese per fshatin Arrez.

Faza III e projekt-zbatimit eshte ndare ne 3 segmente:

1- Segmenti km -0+120 – 1+440, me gjatesi 1560 m

Ky eshte segment i ri qe fillon ne km -0+120, fshati Labinot Fushe, dhe perfundon ne km 1+440 (fillimi i Fazes se I-re te projekt-zbatimit).

Ne kete segment rruga shtrihet ne krahun e djathte te lumit Shkumbin. Nga km 0+300 deri ne km 1+440 rruga kalon mbi gjurmen e rruges ekzistuese. Meqenese ne krahun e majte te rruges kalon hekurudha ekzistuese, zgjerimi i trupit te rruges eshte kryer ne anen e djathte duke u futur pjeserisht ne shtratin e lumit me mbushje te larta. Per te mbrojtur trupin e rruges nga gerryerjet e lumit, skarpata e mbushjes eshte veshur me rip-rap me gure me diameterr minimal 1m dhe qilim gabioni, si edhe jane parashikuar penela me gabione afersisht cdo 100m.

Ne km 0+300 do te realizohet nje lidhje e perkohshme me rrugen ekzistuese e cila do te mbyllet kur te ndertohet Bypass-i i Elbasanit.

2- Segmenti km 1+440 – 10+340, me gjatesi 8900 m

Ky segment parashikon punime asfaltimi dhe sinjalistike, te cilat nuk jane perfshire ne fazat e meparshme te projekt-zbatimit, perkatesisht Faza e I-re km 1+440 – 6+500 dhe Faza e II-te km 6+500 – 10+340.

Ne kete segment jane zhvilluar faza I-re dhe e II-te e projekt-zbatimit. Ne kete projekt, Faza III e projekt-zbatimit, per kete segment parashikohet te realizohen disa punime te cilat nuk u perfshine ne fazat e meparshme, kryesisht shtresa e asfalto-betonit 4cm dhe sinjalistika horizontale.

3- Segmenti km 10+340 – 11+140, me gjatesi 800m

Ky eshte segment i ri qe fillon ne km 10+340 (fundi i Fazes se II-te te projekt-zbatimit) dhe perfundon ne km 11+140, pas ures se re te Murrashit.



Ne kete Segment zhvillohet ne aks te ri ne anen e majte te rruges ekzistuese, me qellim qe rruga ekzistuese te vazhdoje te sherbeje per lidhjen e fsatrave te zones. Ne km 10+900 – 11+140 eshte parashikuar kalimi i lumit Shkumbin me ure te re, mbi uren ekzistuese te Murrashit. Ne km 10+800 eshte parashikuar vendqendrim ne anen e djathte te rruges.

Ashtu sic permendet edhe me siper ky segment rrugor eshte projektuar me parametrat teknike te Kategorise B (Interurbane Kryesore),

- Shpejtesia e levizje **90** km/h.
- Rrezja horizontale minimale eshte **350m**
- Rrezet vertikale minimale jane **6000m** ne kreshta dhe **4000m** ne te lugeta.
- Pjerrësia maksimale gjatesore eshte **6%**.

Gjeresia totale e trupit te rruges eshte 23.5m (per secilin drejtim levizje ka 2 korsi 3.75m, bankine e asfaltuar 1.75m, kunete betoni 0.75m), brezi qendror me gjeresi 2.5m.

Rampat e nyjeve me nje drejtim levizje kane 1 korsi **4.0m** dhe ne secilen ane ka bankine te asfaltuar 1.0m, kunete betoni 0.75m, bordure 0.15m.

Per te minimizuar kostot dhe impaktin ambiental, materiali i pershtatshem qe del nga germimet do te perdoret si material mbushes per trupin e rruges. Ne segmentin 1 do te perdoret zhavori nga germimi i shtratit te lumit, ndersa ne segmentin 3 materiali nga germimi i zonave shkembore.

Paketa e shtresave te rruges kryesore **ne segmentin km 0+120 – 1+440** eshte si me poshte:

- asfalto-beton 4cm
- binder 6cm
- konglomerat 12cm
- stabilizant 20cm
- cakell 60cm (2x2x15cm)
- mbushje me zhavor nga germimi

Ne zonat ku rruga e re kalon ne gjurmen e rruges ekzistuese do te perdoret pakete e pjesshme shtresash me qellim shfrytezimin e shtresave ekzistuese te rruges (Shih Vizatimet, Profilat Terthore).

Paketat e pjesshme te shtresave, qe parashikohen te perdoren, jane si me poshte:

Paketa e pjesshme Tip 1:

- asfalto-beton 4cm
- binder 6cm
- konglomerat 12cm
- stabilizant 20cm
- cakell 30cm (2x15cm)

Paketa e pjesshme Tip 2:

- asfalto-beton 4cm
- binder 6cm
- konglomerat 12cm
- stabilizant 20cm

Paketa e shtresave te rruges kryesore ne segmentin km 1+440 – 6+500 eshte si me poshte:

- **asfalto-beton 4cm**
- binder 6cm (aplikuar ne Fazen I)
- konglomerat 12cm (aplikuar ne Fazen I)
- stabilizant 20cm (aplikuar ne Fazen I)
- cakell 60cm (2x2x15cm) (aplikuar ne Fazen I)
- mbushje me zhavor nga germimi (aplikuar ne Fazen I)

Paketa e shtresave te kryqezimit te Xibrakes, km 2+960:

- **asfalto-beton 4cm**
- binder 6cm (aplikuar ne Fazen I)
- konglomerat 12cm (aplikuar ne Fazen I)
- stabilizant 20cm (aplikuar ne Fazen I)
- cakell 60cm (2x2x15cm) (aplikuar ne Fazen I)
- mbushje me zhavor nga germimi (aplikuar ne Fazen I)

Paketa e shtresave te rruges kryesore ne segmentin km 6+500 – 10+340 eshte si me poshte:

- **asfalto-beton 4cm**
- binder 6cm (aplikuar ne Fazen II)
- konglomerat 12cm (aplikuar ne Fazen II)
- stabilizant 20cm (aplikuar ne Fazen II)
- cakell 60cm (2x2x15cm) (aplikuar ne Fazen II)
- mbushje me material nga germimi (aplikuar ne Fazen II)

Paketa e shtresave te kryqezimit Mirake, km 8+980:

- **asfalto-beton 4cm**
- **binder 6cm**
- **konglomerat 12cm**
- stabilizant 20cm (aplikuar ne Fazen II)
- cakell 60cm (2x2x15cm) (aplikuar ne Fazen II)
- mbushje me material nga germimi (aplikuar ne Fazen II)

Paketa e shtresave te rruges kryesore ne segmentin km 10+340 – 11+140 eshte si me poshte:

- asfalto-beton 4cm
- binder 6cm
- konglomerat 12cm
- stabilizant 20cm
- cakell 60cm (2x2x15cm) (Me material te marre nga germimi i zonave shkembore)
- mbushje me material nga germimi i zonave shkembore

- **Veprat e artit**



Per sa i perket veprave te artit ne kete faze te Projekt-zbatimit eshte parashikuar ndertimi i veprave te vogla te artit (tombino rrethore, tombino box, kanale) dhe veprave te medha te artit (ura).

Ne km 11+000, ura e Murrashit, do te ndertohen 2 ura te reja mbi lumin Shkumbin me konstrukcion beton/arme me trare te parapergatitur, nga nje ure per secilin drejtim te levizjes. Ura majtas me gjatesi 212m dhe ura djathtas me gjatesi 282m.

Gjeresia e ures eshte 13.8m, ka 2 korsi 3.75m, bankine e asfaltuar 0.5m majtas, bankine e asfaltuar 2.5m djathtas, trotuar 1m majtas dhe trotuar 2.3m djathtas.

• **Projektimi hidroteknik, mbrojtja lumore**

Per shkak te pozicionit te trupit te rruges se re, ne projekt-zbatimi eshte parashikuar ndertimi i mbrojtjes lumore ne segmentin km -0+120 deri km 1+440, ne anen e djathte te rrjedhjes se Lumit Shkumbin.

Me qellim mbrojtjen e skarpates dhe trupit te rruges eshte parashikuar vendosja e 14 penelave ne forme T me gabiona.

Midis gabionave eshte parashikuar veshje e skarpates me rip rap me dimensione guresh me te medha se 1m dhe qilim gabioni 2x1x1m ne fundin e skarpates me gjeresi 2m.

Mbrojtjet lumore jane projektuar ne perputhje me Manualin e Mbrojteve lumore si dhe eksperiencat me te mira te realizuara neper bote, te atyre te realizuara ne Shqiperi.

Zgjidhjet teknike jane dhene bazuar ne situaten faktik por edhe fenomeneve te ndodhura me pare me rrjedhen ujore.

Si pjese e projektit te mbrojtjes lumore, rendesi te madhe marin edhe punimet e germimit dhe zgjerimit te shtratit aktual te lumit Shkumbin.

• **Sinjalistika dhe Siguria Rrugore**

Projekti ka te paraqitur planet e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, si dhe janë parashikuar elementët e sigurisë rrugore. Sinjalistika rrugore është përcaktuar mbi bazën e RrTPRr (vëllimi 6) si dhe në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë. Ndërsa element të sigurisë rrugore janë në përputhje me politikat e rregulluara dhe miratuara për sigurinë rrugore që aplikohen në Shqipëri nga qeveria Shqiptare.

Sinjalistika vertikale do të përmbajë:

Tabelat Detyruese.

Tabelat Treguese.

Tabelat Paralajmëruese.

Tabelat e rrezikut.

Tabela Informuese

Të gjitha tabelat do vendosen në bankina, brezin e gjelbërt ose në traversat mbi rrugë. Këto tabela janë vendosur në një distancë që shoferi të mund të marrë masat e nevojshme për ti zbatuar ato dhe gjithashtu kanë dimensionin dhe shikueshmerine e duhur në perputhje me klasifikimin e rrugës së projektuar.

Sinjalistika horizontale

Vijëzim gjatësor 15/25 cm Shigjeta drejtimi dhe shkrime. Ishuj trafiku. Materialet e përdorura për sinjalistikën horizontale janë rezistente dhe me reflektimin e nevojshem për të siguruar shikueshmeri të larte, kjo sepse sinjalistika horizontale është në kontakt të vazhdueshem me automjetet që lëvizin me shpejtesi të lartë. Do të realizohet me bojë termoplastike.

Është shumë e rëndësishme që sinjalistika vertikale dhe horizontale të jenë në harmoni me njëra-tjetrën ndërmjet pjesëve të ndryshme të rrugës, me qëllim shmangien e çdo keqkuptimi nga përdoruesit e rrugës.



Elementët e sigurisë rrugore

Në aksin kryesor në ndarjen midis 2 karraxhadeve do të vendosen Neë Jersey ndërsa në pjesët anësore në të gjithë gjatësinë do të vendosen guardrail anesor H2/W3 me 3 valëzime, me përjashtim të zonave ku parashikohen mure pritës. Në afërsi të ishujve të kryqëzimeve janë vendosur amortizatorë të goditjeve.

Përsa i përket vendosjes së sinjalistikës horizontale dhe vertikale për (Faza III), duhet të realizohet nga kontraktori, një plan i detajuar i menaxhimit të trafikut dhe sinjalistika e përkohshme, deri në ndërtimin e segmentëve të tjerë të aksit të plotë Elbasan – Qafë Thanë.

- **Sistemi i linjave rezervë**

Duke qënë se aksi është korridori kryesor që lidh lindjen me perëndimin e vendit tonë, në projekt janë parashikuar ndërtimi i linjave rezervë elektrike dhe për fibrat optike. Linjat rezervë do përbëhen nga tre tuba P.V.C. me diameter 100mm, të vendosur nën bankinën e paasfaltuar të rrugës.

Përgjatë linjave rezerve, në interval 100m dhe në kryqëzime apo intersektimet e rrugëve do të ndërtohen puseta me kapak gize [80x80x150] cm.

III– OBJEKTIVI KRYESOR

Mbikqyrësi i punimeve ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjekë mbarëvajtjen e të gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve të këtij objekti dhe anën ekonomike të tij (vlefë e kontratës).

IV- DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E MBIKQYRËSIT

Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të objektit: **“Supervizion punimesh zgjerimi i rrugës Elbasan – Qafë Thanë”, (Faza III)**, mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të mbikqyrë Kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas Kontratës së nënshkruar dhe sipas Ligjit Nr. 8402 datë 10.09.1998, të ndryshuar, VKM Nr.3 dt.15-02 2001, VKM Nr.1 dt. 22.02.2005, VKM Nr 2 dt.13.5.2005 dhe të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim.
 - Të njihet në detaj me projekt zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit.
 - Të hartoj programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standarteve të përcaktuara me ligj.
- Të paraqesë pranë ARrSH-së stafin e tij mbikëqyrës.

Shënim:



- Në bazë të volumit të punimeve dhe vlefës së kontratës, drejtuesi i punimeve duhet të jetë rezident në objekt dhe stafi tjetër mbikëqyrës mund të jetë rezident çdo ditë në objekt ose me kohë të pjesshme në funksion të specifikave të punës.
- Mbikëqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktuar me ARrSh-në, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin dhe probleme të tjera, etj.
- Mbikëqyrësi vihet në dijeni nga ARrSh-ja për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontratën e nënshkruar dhe miratuar nga ana e tij (investitori).
- Mbikëqyrësi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet qeverisëse në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt dhe informon për personat kryesor përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti në përputhje me nenin 9 të ligjit Nr.8402, dt 10.09.1998

Mbikëqyrësi ka për detyrë:

- Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, të autorizimeve dhe të lejeve, të cilat sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve.
- Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.
- Të njihet mirë me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe të njohë të gjitha ndryshimet e mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës.
- Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit më këto të dhëna:
 - Emërtimi i objektit: **“Supervizion punimesh zgjerimi i rrugës Elbasan – Qafë Thanë”, (FAZA III),**
 - Investitori: “Autoriteti Rrugor Shqiptar”
 - Projektuesi : “Autoriteti Rrugor Shqiptar”
 - Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik: “ _____ ” sh.p.k
 - Mbikëqyrësi: _____
 - Afati i ndërtimit të objektit: _____ 24 Muaj

Mbikëqyrësi menjëherë mbas lidhjes së Kontratës duhet :

- Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabetave përkatëse sinjalizuese, treguese të sigurisë, shiritave, fenerëve etj.
- Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë ARrSh-së të gjithë dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen:
- Stafi i Sipërmarrësit,
- Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit.
- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar.
- Të kontrollojë zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka dhe ti rekomandojë ARrSh-së zgjidhjet konkrete.

- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta duke dhënë udhëzime porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të dispozitave përkatëse të kontratave.
- Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme piketimin e objektit.
- Të kontrollojë çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.
- Për çdo punim të maskuar të bëjë fotografimin ose regjistrim e tij dhe të mbaj proces-verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarësit.
- Në çdo fund ditë pune të kontrolloj ditarin e punimeve dhe të firmos atë.
- Të kontrollojë librin e masave i cili vërteton volumin e punimeve dhe ta miratoj atë.
- Të kontrollojë çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen në objekt të tyre.
- Gjatë zbatimit të projektit i jep instruksione me shkrim sipërmarësit sa herë që e sheh të nevojshme, dhe sipërmarësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë.
- Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projektin dhe Preventivin e parashikuar, Mbikëqyrësi i Punimeve duhet t'i paraqesë ARRSH -së një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga ARRSH -ja.
- Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqes pranë ARRSH -së raport mujor të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve dhe të pagesave të kryera. Realizimi i punimeve në vleftë dhe % , afati kohor i realizimit të financimit.
 - ❖ Raporti Mujor do të ketë këtë përmbajtje:
 - Hyrje.
 - Informacion i përgjithshëm.
 - Të përgjithshme.
 - Qëllimi i punimeve.
 - Mbikqyrja e punimeve ndërtimore.
- Personeli i siguruar nga Mbikëqyrësi.
 - Staf i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve .
 - Staf aktual.
 - Kohqëndrimi në objekt për secilin.
- Raportimi.
- Kohzgjatja e shërbimit të Mbikëqyrjes.
- Përshkrimi i Projektit.
 - Shtresat Rrugore.
 - Veprat e Artit etj.
- Organizimi i Sipërmarësit
 - Sipërmarësi.

- Stafi prezent.
- Mjete dhe makineri.
- Kohqëndrimi në objekt.
- Progresi Mujor.
- Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave).
- Fotografi të proceseve të punimeve të kryera.
- Fotografi të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm.
- Grafiku i ecurisë së punimeve:
 - Të aprovuara.
 - Të kryera.
- Volumet Progresive të Punimeve Mujore:
 - Punimet e aprovuara.
 - Çertifikatat e cilësisë dhe Provat Laboratorike.
 - Libreza e Masave.
 - Punimet e kryera por të pa aprovuara.
 - Situacionet mujore.
 - Matjet topografike.
- Korrespondenca:
 - Proces-Verbale.
 - Urdhëra, udhëzime, njoftime.
 - Ndryshime në Projekt dhe Preventiv nëse ka (të aprovuara nga ARRSH-ja).
- Moti (kalendarik).
- Problemet që kanë dalë:
 - Teknike.
 - Sociale.
- Konkluzione.

Shënim:

- *Raporti Mujor dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pesë kopje dhe tre kopje të dorëzohen në ARRSH pranë Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Brendshme,*
- *Raporti Mujor do t'i dorëzohet ARRSH-së brenda datës së caktuar në kontratë.*
- *Mbikqyrësi do të mbajë kontakte të vazhdueshme me ARRSH-në (Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes, Sektorit të Menaxhimit të Projekteve të Brendshme, si dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Operacioneve, Sektorit të Hartimit të Projekteve të Brendshme) dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.*

Mbikqyrësi mban përgjegjësi të plotë.

Në fillim të punimeve, Mbikqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:

- Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori së bashku me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologjiko-inxhinierik të bazamentit ku do të kryhen punimet.

- Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Saktësinë e vërtetësisë së dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.
- Për realizimin pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarrësit dhe A.RR.SH-së dhe të gjitha fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
- Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikqyrësit.
- Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me Sektorin e Menaxhimit të Projekteve të Brendshme, dhe Sektorin e Shpronësimeve, urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që i kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve.

Për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon në rast se gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërrim të mbikqyrësit, i gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërrimi.

Mbikqyrësi ka të drejtë :

- Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të vecantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
- Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor, n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
- Të pezullojë punimet kur shihet se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
- Të mos lejoj vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësojë ato me materiale të tjera nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij.
- Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materialeve.
- Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.
- Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurt dhe cilësore.
- Të mos lejoj përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike.
- Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikqyrësi, këto duhet të dokumentohen me procesverbalet e analizave të provave së bashku me aktin teknik, ku të argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt-zbatimit.
- Kur Mbikqyrësi i Punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve në rrugë kontraktuale.

- Mbikëqyrësi i Punimeve urdhëron Sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt dhe Specifikimet Teknike.
- Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, për çdo rast me miratimin e ARRSH-së për aq kohë sa ai e konsideron të arsyeshme. Në këtë rast sipas shkakut, Mbikëqyrësi së bashku me ARRSH-në dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- Të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezervë të preventivuar dhe i raporton periodikisht ARRSH-së për gjendjen e tij.
- Për çdo ndryshim të mundshëm mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.

Në përfundim të punimeve mbikëqyrësi:

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proces-verbal datën e përfundimit të tyre sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës dhe brenda 30 ditëve merr prej sipërmarrësit dokumentacionin përkatës.
- Duke u mbështetur në Ligjin 8402, dt 10.09.1998, VKM Nr. 2 datë 13.5.2005 dhe VKM Nr. 3 datë 15.02.2001, dorëzon pranë ARRSH-së (Sektorit të Sigurimit të Cilësisë dhe Dorëzimit) të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë, vërtetësinë e tij.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë :

- Proces-verbal i dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
- Proces-verbal për fillimin e punimeve.
- Kontratën e sipërmarrësit.
- Kontratën e mbikëqyrjes.
- Projekt organizimi i punimeve.
- Projektin.
- Projektin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme.
- Preventivin fitues.
- Preventivin e ndryshuar (nëse ka zërat të rinj të punimeve negocimin e tyre).
- Grafiku i punimeve.
- Specifikimet teknike.
- Axhornimi para fillimit të punimeve dhe pikëtimi.
- Dokumentacioni topografik dhe gjeologjik inxhinjrik për ndërtim rrëshqitje.
- Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi për punimet e padukshme.
- Proces-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi, të shoqëruar me fotografi.
- Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi.
- Libreza e masave.
- Shkresën e mbikëqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezervë të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
- Proces-verbal i përdorimit të fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarrësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi.

- Preventivi i fondit rezervë të firmosur nga sipërmarësi (drejtusi teknik) dhe mbikqyrësi.
- Situacion i fondit rezervë të firmosur nga Sipërmarësi (drejtuesi teknik) dhe mbikëqyrësi.
- Çertifikatat e cilësisë së materialeve.
- Miratim i materialeve të përdorura nga mbikëqyrësi.
- Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar.
- Regjistri i kontabilitetit.
- Deklarata teknike e sipërmarësit e firmosur nga sipërmarësi dhe drejtuesi teknik.
- Njoftimi i sipërmarësit për përfundimin e punimeve.
- Proces-verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarësi dhe mbikëqyrësi së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar.
- Relacioni përfundimtar i mbikëqyrësit.

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e tij. Ky dokumentacion është në 3 (tre) kopje. Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudit që ngrihet me urdhër nga ARRSH -ja brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që i dorëzohen Grupit të Kolaudit pranë ARRSH -së duhet të jenë origjinalë.

Mbikëqyrësi i Punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet Grupit të Kolaudit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudit të objektit dhe nënshkruan aktin përkatës. Pas përfundimit të kolaudit, mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit i cili i bëhet e ditur sipërmarësit dhe i jepet për të likuaduar ARRSH-së.

V - KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES

Bazuar në “Grafiku i punimeve”, pjesë e projekt – zbatimit të objekti “Zgjerimi i rrugës Elbasan – Qafë Thanë, (FAZA III)”, është parashikuar që zbatimi i punimeve të ndërtimit të zgjas 24 muaj.

Pa u kushtëzuar nga sa më sipër, kohëzgjatja e shërbimit të mbikëqyrjes do të jetë për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve, deri në përfundim të objektit.

VI - TË DREJTAT E ARRSH-së.

ARRSH-ja ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikëqyrësit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara.
- Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet. Tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike.

Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, ARRSH-ja ka të drejtë të urdhëroj mbikqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjëndjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje

administrative, vendosen sanksione në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit Nr. 8402 dt. 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

VII - MËNYRA E DHËNIES SË OFERTËS.

Oferta jepet në vleftë totale e zbërthyer në shpenzime për muaj - njëri (sipas preventivit bashkëngjitur) dhe shpenzime të tjera të nevojshme për tu kryer.

VIII - MËNYRA E PAGESËS.

Pagesa do të bëhet mujore në bazë të % së realizimit të punimeve të zbatimit e zbërthyer sipas shpenzimeve në muaj për njeri.

PREVENTIV

MBIKQYRJE PUNIMESH

Objekti: *“Supervizion punimesh zgjerimi i rrugës Elbasan – Qafë Thanë”, (FAZA III).*

Kodi	Emërtimi	Njësia	SHPENZIMET	
			Çmimi	Vlefta
	Stafi			
1.	Drejtor projekti	Staf - muaj		
2.	Inxhinier për strukturat	Staf - muaj		
3.	Inxhinier për punimet topografike	Staf - muaj		
4.	Inxhinier për punimet gjeologjike	Staf - muaj		
5.	Inxhinier për punimet e sinjalistikës	Staf - muaj		
6.	Inxhinier për punimet hidroteknike	Staf - muaj		
7.	Inxhinier për punimet e mjedisit	Staf - muaj		
	Shuma 1			
	Shpenzime			
	Shpenzime të ndryshme	Lump sum		
	Paisje, maeriale etj	Lump sum		
	Shuma 2			
TOTALI				

MBIKQYRËSI I PUNIMEVE

DUKE JU REFERUAR VKM 354 DT.11.05.2016 LLOGARITJA E FONDIT LIMIT
ËSHTË BËRË SI MË POSHTË VIJON.

VLERA E NDËRTIMIT PA TVSH	2,499,796,130.52 LEK
VLERA E NDËRTIMIT ME TVSH	2,999,755,356.62 LEK
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKQYRJE PA TVSH	23,075,043.67 LEK
VLERA MAKSIMALE PËR MBIKQYRJE ME TVSH	27,690,052.40 LEK

1. STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT GRUPI IV TARIFOR
2. VEPRA INXHINIERIKE/ARTI GRUPI IV TARIFOR
3. SHËRBIMI I TOPOGRAFISE PËR FAZËN E NDËRTIMIT PËR
STRUKTURAT E TRANSPORTIT DHE QARKULLIMIT GRUPI IV TARIFOR
4. SHËRBIMI I TOPOGRAFISË PËR FAZËN E NDËRTIMIT PËR:
VEPRA INXHINIERIKE/ARTI GRUPI IV TARIFOR

